



WWF

FACTSHEET

2012



Parqet e Harkut Dinarik

OBJEKTIVI

Ruajtja dhe forcimi i vullnetit politik për dialog dhe bashkëpunim mes vendeve të Harkut Dinarik

Harku Dinarik është një rajon i Evropës jug-lindore i cili mbulon rreth 100,000 km² dhe më shumë se 6.000 km vijë bregdetare, që shtrihet në zonën e orientuar në drejtim të detit Adriatik, nga Trieste (Itali) në Tiranë (Shqipëri).

TERRITORI

Parqet Dinarike përfshijnë territorin e Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës*, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Sllovenisë

WWF ka filluar projektin e Parqeve të Harkut Dinarik në fillim të vitit 2012, me qëllim për të krijuar një shoqatë të parqeve kombëtare dhe atyre natyrore në territorin e vendeve përbërëse të Harkut Dinarik; aleancë Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë*, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi dhe Slloveni. Ky projekt tre-vjeçar është financuar nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme dhe Fondacioni MAVA.

75 PARQE

Parqet e harkut do të përfshijnë 75 parqe kombëtare dhe natyrore nga tetë vende

Rrjeti rajonal i zonave të mbrojtura

Objektivi i parë dhe kryesor i këtij projekti është që të krijojë një rrjet të zonave të mbrojtura duke lidhur të gjitha parqet në rajonin e Harkut Dinarik. Një **konferencë e planifikuar pesë-ditore për parqet**, që do të mbahet në fund të çdo viti të projektit, do të ndihmojë menaxherët dhe stafin e parqeve për t'u njohur me kolegët e tyre në rajon, shkëmbimin e planeve menaxhuese dhe shembuj të praktikave të mira, si dhe të planifikojnë bashkëpunim të mundshëm ndërmjet zonave të mbrojtura.

200

Pjesëmarrës do të përfshihen në aktivitetet e projektit

Plani përfshin gjithashtu vizita studimore nga një vend i rajonit në një tjetër, duke ndihmuar stafin e parqeve të kuptojnë më mirë situatën e parqeve të tjera në rajon. Ekipi i projektit do të ofrojë **mbësh-tetje teknike** për ato parqe që do vendosin për të hyrë në një projekt të përbashkët me një tjetër park në rajon, ndërsa sekretariati i projektit do të shërbejë si ndërlidhje ndërmjet të gjithë parqeve në rrjet. Vlerat më të rëndësishme të parqeve dhe zonave të mbrojtura brenda rrjetit, do të evidentohen përmes materialeve promovuese dhe në faqen e internetit të ndërtuar për të përmirësuar promovimin e parqeve të Harkut Dinarik.

* Ky përcaktim është pa paragjykim në lidhje me pozicionet rreth statusit, si dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/99 dhe opinionin e GJN mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës

Ngritja e kapaciteteve për rrjetin e parqeve

Parqet Kombëtare dhe natyrore në të gjitha vendet e Harkut Dinarik janë kryesisht ose tërësisht të varur nga financimet e shtetit. Kjo është arsyeja pse një seri seminaresh për **ndërtimin e kapaciteteve** do të mbahet në kuadër të këtij projekti.

Të gjitha vendet pjesëmarrëse në këtë projekt, nëse nuk janë aktualisht anëtare, tashmë janë afër për t'u bërë anëtare të Bashkimit Evropian (BE), ndaj ne do të organizojmë një seri me seminare dhe vizita studimore rreth *Natura 2000* dhe **rolin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura në BE**.

Bukuria, kultura, pozita gjeografike dhe diversiteti biologjik i vendeve të Harkut Dinarik janë tashmë një atraksion turistik. Megjithatë, pritjet që parqet e Harkut Dinarik do të jenë një magnet për operatorët turistikë. Ne do të sigurojmë që punonjësit e zonave të mbrojtura të përfshihen në *Kartën Evropiane për Turizmin e Qëndrueshëm të Federatës EUROPARC*, si dhe për zbatimin e saj praktik në rajonin tonë. Ne do të organizojmë seminare për punonjësit e agjencive të udhëtimit, si dhe do të organizojmë turne të ndryshme studimore, në të cilat jo vetëm punonjësit e turizmit, por edhe gazetarë nga rajoni do të mësojnë më shumë për bukuritë e parqeve dhe biodiversitetin e tyre.

Parqet e Harkut Dinarik si një markë

Me vlerat natyrore dhe kulturore që mbart, Harku Dinarik qëndron përkrah Karpateve, Alpeve apo ndonjë eko-rajoni tjetër të njohur në botë. Kur ne tashmë jemi duke krijuar një rrjet të parqeve të Harkut Dinarik, pse të mos krijojmë një markë që do ta vendoste rajonin tonë ndërmjet destinacioneve të ardhshme turistike më të njohura të botës?

Nëpërmjet faqes sonë të internetit, broshurave, mjeteve të ndryshme të komunikimit dhe, në fund të fundit, një fushate të gjerë reklamuese, ne do të përpiqemi për të zhvilluar parqet e Harkut Dinarik si një markë që do të njihet në rajon dhe më gjerë deri në vitin 2015. Ne do të zhvillojmë bashkëpunimin me ministrinë e turizmit dhe agjencitë e udhëtimit dhe do të gjejmë një mënyrë sa më të mirë për të promovuar markën e Parqeve Dinarike.



SALAMANDA E SHPELLËS (*PROTEUS ANGUINUS*)

© SLAVKO POLAK



GORNJE PODUNAVLJE, SERBIA

© WILD WONDERS OF EUROPE / RUBEN SMIT / WWF

Rritja e kapaciteteve:

1. roli i zonave të mbrojtura në BE
2. zhvillimi lokal dhe bashkëpunimi me sektorin privat
3. turizëm
4. ndryshimet klimatike

Marka:

1. faqe web
2. fushatë në media
3. publikime
4. fushata reklamuese
5. bashkëpunim me operatorë turistike

Më shumë informacion:

www.discoverdinarides.com

WWF Programi Mesdhetar:

Drejtori i Projektit
Dr. sc. Deni Porej
Tel. +381 63 1052 050
dporej@wwfmedpo.org

Menaxher i Projektit
Leon Kebe
Tel. + 385 91 1753 081
lkebe@wwfmedpo.org

Ngritja e kapaciteteve
Andrea Štefan
Tel. +385 91 1753 080
astefan@wwfmedpo.org

Komunikimi
Petra Boić Petrač
Tel. +385 91 2905 976
ppetrac@wwfmedpo.org

Ndihmëse në projekt
Ivana Korn Varga
Tel. + 385 99 6773 619
ikorn@wwfmedpo.org

PROJEKTI ËSHTË FINANCIUAR NGA
MINISTRIA NORVEGJEZE E PUNËVE TË
JASHTME DHE FONDACIONI MAVA.



Pse ne jemi këtu:

Për të ndaluar degradimin e mjedisit natyror të planetit dhe për të ndërtuar një të ardhme në të cilën njerëzit të jetojnë në harmoni me natyrën.

www.croatia.panda.org

Shtypur në kuadër të projektit "Parqet e Harkut Dinarik" i cili zbatohet nga WWF Programi mesdhetar, dhe i financuar nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme dhe Fondacioni MAVA. Ky tekst lejohet të kopjohet, nëse citohet burimi. Shtypur në letër miqësore me mjedisin. www.panda.org

